



**REPUBLIKA E SHQIPERISE
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

**V E N D I M
PËR MIRATIMIN E VËZHGUESIT TË MEDIAS TË RTK - RADIO TELEVISIONI
KOSOVËS, PËR VËZHGIMIN E ZGJEDHJEVE PËR ORGANET E QEVERISJES
VENDORE TË DATËS 30 QERSHOR, 2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 06.06.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Miratimi i gazetarit të Radio Televizioni i Kosovës, për vëzhgimin e zgjedhjeve për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, gërma "a", neni 6, pika 2, 4, 5, të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe Udhëzimi nr.13, datë 22.04.2009 "Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja dhe mediave"

V Ë R E N

Radio Televizioni Kosovës, ka shprehur interes për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.

Radio Televizioni Kosovës ka paraqitur kërkesën e saj me nr. Prot7813 , datë 05.06.2019, bashkë me dokumentacionin mbështetës pranë KQZ për akreditimin e 1 (një) gazetari. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve vëren se ai është brenda kushteve dhe kërkesave të parashikuara nga Kodi Zgjedhor



Nr. 797

i Vendimit

Data 06 .06.2019

Ora 18 .⁰⁰

Për miratimin e gazetarit të Radio Televizioni i Kosovës, për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në nenin 23, pika 1, gërma "a", neni 6 , pika 2, 4, 5 të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 13, datë 22.04.2009 "Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja dhe mediave", Komisioni Qendror i Zgjedhjeve:

V E N D O S I :

1. Të miratojë kërkesën e Radio Televizionit të Kosovës për akreditimin e 1 (një) gazetari për vëzhgimin e procesit zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019, sipas listës bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI	Anëtare

